

Plani i Veprimit mbi Implementimin e Rekomandimeve të ZKA-së (nga letra e menaxhmentit) për vitin 2021

Nr.	Çështjet e ngritura nga Auditori	Rekomandimi i Auditorit	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit	Komente
1	Çështja A1 Mos përputhje në mes granteve të shtyra dhe asetëve të financuara nga grantet e shtyra	Bordi i Drejtoreve duhet të siguroje se vlera e detyrimeve ndaj garantit të njihet dhe prezantohet sakte në PFV si dhe të merren masat e nevojshme korrigjuese për gabimet në lidhje me regjistrimet e pasurive të financuara nga grantet.	Veprimet nga departamenti i financave janë ndërmarr gjatë vitit 2021 dhe këtë e vërteton raporti auditorit për vitin 2021, ku për këtë gjetje thekson se është zbatuar (përmbledhja e rekomandimeve 2020, pika 3). Të sigurohemi që të hyrat nga grantet të trajtohen sipas standardit ndërkombëtare të kontabilitetit.	Sektori Kontabilitetit / Menaxheri	Vazhdimisht	Ne nuk jemi pajtuar me këtë gjetje, mirëpo do të veprojmë sipas kërkesës së ZKA-së duke respektuar SNK.
2	Çështja A2 Mbivlerësim i llogarive të arkëtueshme dhe mbivlerësim i të hyrave	Bordi i Drejtoreve duhet të siguroje që të fuqizohen kontrollet e brendshme në mënyrë që zbritjet (debit notat) nga klientët të aplikohen dhe të merren hapat e nevojshëm që ato të trajtohen sipas kushteve të kontratës si dhe të merren veprimet e nevojshme për harmonizimin e të dhënave në mes ndërmarrjes dhe klientëve të saj në baza periodike.	Për këtë pikë DF i ka marr veprimet e nevojshme në prill 2022. Për të njëjtën kemi paraqit edhe dëshmitë.	Sektori i kontabilitetit / Menaxheri	E zbatuar, Prill 2022	Ne nuk jemi pajtuar me këtë gjetje, mirëpo do të veprojmë sipas kërkesës së ZKA-së duke respektuar SNK.
3	Çështja A3 Nënvlerësim i obligimeve tatimore dhe mos prezantim i saktë i shpenzimeve të interesit dhe	Bordi i Drejtoreve duhet të siguroje që kontrollet financiare të jenë me efektive dhe azhurnimi i të dhënave të behet me kohe në mënyrë që llogarite tatimore dhe regjistrimet kontabël të	Kjo gjetje nuk bazohet në të dhëna të sakta dhe nuk qëndron.	Sektori i kontabilitetit / Menaxheri	Vazhdimisht	Ne nuk jemi pajtuar me këtë gjetje, mirëpo do të veprojmë sipas kërkesës së ZKA-së

	ndëshkimeve tatimore	reflekojnë prezantimin e drejtë të gjendjes në pasqyra financiare.				duke respektuar SNK.
4	Çështja B1 Mos rivlerësimi i pasurive afatgjata	Bordi i Drejtorëve të sigurojë krijimin e një mekanizmi të kontrollit që monitoron të gjitha detyrimet ndaj operatorëve ekonomik, në mënyrë që faturat të paguhen brenda afateve kohore të përcaktuara me kontratën në mes të dy palëve.	Ne si ndërmarrje kemi marr veprimet e nevojshme gjatë vitit 2021 dhe kemi tenderuar dy here për të kontraktuar operatorët ekonomik për rivlerësim të asetëve, mirëpo në të dy rastet nuk kemi pasur ofertues të përgjegjshëm, gjithashtu pengesë ka qenë edhe mos funksionimi i OSHP-së.	Menaxhmenti	Do të shqyrtojmë mundësin e zhvillimit të procedurave të prokurimit gjatë vitit 2022.	
5	Çështja A4 Mos pagesa e kontributeve pensionale dhe obligimeve tatimore	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që të gjitha obligimet e prapambetura të kontributeve pensionale të paguhen sa me parë si dhe të nderpritet praktika e pagesës së pagave, pa pagesën edhe të tatimeve dhe kontributeve në paga.	Ndërmarrja në Maj të vitit 2021 ka hyrë në marreveshje me Administratën Tatimore për pagesën me këste të këtyre obligimeve. Këto obligime janë rritur ndër vite si mungesë e gjendjes jo të mirë financiare.	Menaxhmenti	Vazhdimisht	
6	Çështja A5 Prezantim jo i plotë i shënimeve shpjeguese	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që shenimet shpjeguese përmbajnë parimet bazë që perdoren për hartimin e pasqyrave financiare dhe informacione mbi përbërjen e zërave të pasqyrave, janë dhënë sipas kërkesave të standardeve të kontabilitetit.	Ndër vite shenimet shpjeguese kanë qenë sipas SNK dhe nuk kemi pas gjetje dhe e kemi konsideruar që janë në rregull. Këtë ne do ta shqyrtojmë dhe do të shohim se ku janë mangësitë dhe do të marrim veprimet e duhura, në mënyrë që të rregullohen sipas kërkesave të SNK.	Spektori i Kontabilitetit / Menaxheri	Gjatë vitit 2022	

7	Çështja A6 Mos harmonizimi i gjendjes së stokut me regjistrat kontabël	Bordi i Drejtoreve të siguroje që me rastin e inventarizimit të stoqeve, të bëhet harmonizimi i gjendjes faktike të stoqeve me regjistrat kontabël, në mënyre që të prezantohet vlera e drejte e tyre në pasqyra financiare.	Menaxhmenti gjatë këtij viti do të kërkoj nga komisioni i regjistrimit të stoqeve (paisjeve rezervë) që para përfundimit të raportit të sigurohet nga DF që janë përfshirë të gjitha faturat (hyrje-daljet në depo) dhe ta raportoj saktë gjendjen faktike të tyre.	Menaxhmenti	Dhjetor/Janar 2022-2023	
8	Çështja B2 Mungesë e dëshmime burimore për parapagimet	Bordi i Drejtoreve duhet të siguroje se ekzistojne të gjitha dëshmitë e duhura valide që konfirmojne të drejtat e ndërmarrjes për këto parapagime. Në të kundërtën, ne qoftë se nuk konstatohen të drejtat e ndërmarrjes për këta furnitorë, të bëjë korigjimet e duhura kontabël.	Departamenti i financave do të hartojë një raport në lidhje me secilin furnitor / klient dhe mundësinë e mbylljes së parapagimeve apo edhe fshirjen e tyre nëse nuk kemi dokumentacion të mjaftueshëm. Për këtë gjetje gjatë vitit 2021 menaxhmenti ka formuar komisionin për II/a dhe II/p e vjetra i cili do ta shqyrtoj edhe këtë gjetje duke u bazuar në dokumentacionet për furnitorët. Në fund do të dal me një propozim / rekomandim për veprimet cilat duhet ti merr departamenti i financave.	Sektori i Kontabilitetit / Menaxheri	Gjatë vitit 2022	
9	Çështja A7 Mos klasifikim i saktë i të ardhurave nga shitja e aseteve	Bordi i Drejtoreve duhet të siguroje se me rastin e shitjeve të pasurive, të bëhet trajtimi i duhur i tyre bazuar në kerkesat e standardeve të kontabilitetit me qëllim që efektet e shitjes së pasurive të pasqyrohen drejtë në kontabilitet dhe pasqyra financiare.	Është korigjuar klasifikimi dhe është regjistruar sipas SNK.	Sektori i Kontabilitetit	Imlementohet gjatë përgatitjes së PFV 2022	

10	Çështja A8 Mos hartimi i Statutit të Auditimit të Brendshëm	Bordi i Drejtoreve në bashkepunim me Komisionin e Auditimit duhet të sigurojë që është hartuar Statuti i Auditimit të Brendshëm, i cili përcakton natyrën e shërbimeve që do të ofrohen brenda ndermarrjes, pozicionin, autoritetin dhe përgjegjësin e aktiviteteve të auditimit të brendshëm në kompani.	Në momentin e përzgjedhjes së Zyrtarit të Lartë të Auditimit bashkarisht me komitetin e auditimit do të fillojnë procedurat e hartimit të Statutit të Auditimit të Brendshëm.	Zyrtari i lartë i Auditimit dhe Komiteti i Auditimit	Në momentin e përzgjedhjes së Zyrtarit të Lartë të Auditimit	
----	--	---	---	--	--	--

Fushë Kosovë,

28.06.2022

Për Bordin e Drejtoreve të Trainkos Sh. A.

Ramush AHMETAJ - Kryesues

